

OKETA PREZANTON PROJEKTIN
PREJ 400 MLN DOLLARËSH

Nis nga puna financimi i Bankës Botërore për rrugët rurale

Projekti për financimin e rrugëve rurale nga Banka Botërore, me vlerë 400 milionë dollarë, nisi nga puna. Ky projekt u prezantua dje nga zëvendëskryeministri Gazmend Oketa, në cilësinë e kreut të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në një takim të organizuar për këtë çështje. Në fjalën e tij, zëvendëskryeministri Oketa prezantoi projektin, si dhe vlerësoi mbështetjen e Bankën Botërore për zbatimin e projekteve të tilla. Ky është një projekt ambicioz i qeverisë shqiptare, i mbështetur nga BB-ja dhe që do të realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. "Me anë të këtij projekti, qeveria do të synojë të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend, si edhe për shtimin e aksesit ndaj shërbimeve themelore dhe tregjeve ekonomike, veçanërisht në zonat rurale", theksoi Oketa. Gjithashtu, zëvendëskryeministri Oketa theksoi se komponentët kryesorë të këtij projekti do të jenë përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit dytësor dhe lokal të rrugëve në gjithë Shqipërinë, si dhe futja e kontratave të mirëmbajtjes, duke kontraktuar sektorin privat për rrjetin lokal të rrugëve. Ndër të tjera, ai solli në vëmendje të pranishmëve që rëndësia e këtij projekti është fuqizimi i organizmave përgjegjës për menaxhimin e rrjetit rrugor lokal dhe konsolidimin e përgjegjësive institucionale për menaxhimin dhe planifikimin nga sektori i rrugëve sekondare. Në fund të këtij projekti, i cili do të zgjasë 5 vjet, parashikohet të ngrihet jo vetëm një rrjet dytësor dhe komunal i përmirësuar në mënyrë rrënjësore, por edhe një inventar i rifreskuar i të gjitha rrugëve rajonale, duke mundësuar njohjen në kohë reale të nevojave për investim dhe për mirëmbajtjen e tyre.